



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtine



**KOLEGJI "BIZNESI"**

Nr: 456/20 Data: 01.12.20  
**PRIZREN**

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriaz" nr 29. të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. Bajfa Plast, Adresa: "Mushnikovë" p.n. 20530 Reqanë-Prizren R. e Kosovës, me NRB 810574691.

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI-Prishtinë dhe Bajfa Plast-Prizren, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Bajfa Plast-Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi Bajfa Plast-Prizren në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i Emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.
3. Kolegji Biznesi do të mbështesë Bajfa Plast-Prizren me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomisë dhe Jurisprudencës-sipas nevojave që paraqet Bajfa Plast.

Neni 4  
Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këtij memorandumi është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5  
Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 6  
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë  
  
/Prof. Dr. Shyqet Kabashi/  
Dekan  


Bajfa Plast N. P. Q.

  
/Faik Bajrami/  
Drejtor  


Nënshkruar në Prishtinë, me datë 01/12/2020